

# TË DHËNAT PËR QEVERISJEN NË ENERGJETIKË: SHQIPËRI

Përditësuar për herë të fundit: 20 Dhjetor 2015

## ÇËSHTJET KRYESORE:

- Sfidat në sigurinë e furnizimit, besueshmërinë e infrastrukturës, dhe funksionimin e tregut të energjetikës.
- Tenderët e energjetikës janë zbatuar jashtë procedurave të përgjithshme të prokurimit publik, duke rritur risqet e korrupsionit.
- CEO-t e kompanive energjetike shtetërore ndryshojë kur qeveritë ndryshojnë, duke treguar emërime politike dhe jo profesionale.
- Pavarësisht performancës negative të disa ndërmarrjeve shtetërore, drejtuesit nuk mbajnë përgjegjësi për shkak të lidhjeve politike, një tjetër tregues ky i risqeve të korrupsionit.
- Sektori i energjisë elektrike po vuan nga defiçite të larta, duke dëshmuar për pazare politike, risqe korrupsioni dhe qeverisje të dobët në sistem.
- Diversifikimi i ulët i burimeve të energjisë.
- Ndryshimet e shpeshta në kuadrin ligjor tregojnë paqëndrueshmëri në vendimmarrje dhe nevojën për ndërhyrje politike.
- Liberalizimi i tregut është ende i largët, pavarësisht progresit në nivel legjislativ. Mungesa e legjislacionit sekondar dhe e përvojës së tregut në administratën publike dhe në vetë Ndërmarrjet Shtetërore kërcënojnë një rritje të korrupsionit dhe mashtrimin në sistemin e transmetimit.

BURIMI: Raporti Rajonal i Vlerësimit të Qeverisjes dhe Kapjes së Shtetit në Energjetikë, SELDI, 2016.


**TABELA 1: Gjendja e liberalizimit të sektorit të energjisë elektrike (kualifikimit, hapjen e tregut, rregullimin e çmimeve dhe ndarjen e operatorëve)**

Rregullimi i Çmimit	Ligji i ri i sektorit të energjisë elektrike (2015) liberalizoi (çrregulloi) çmimet e prodhimit dhe furnizimit për të gjithë klientët e lidhur me linjat e energjisë 110 kV e lart dhe për ata me një konsum vjetor mbi 50 GWh. Tarifat e energjisë për familjet dhe bizneset mbetet të rregulluara në formë administrative.
Kualifikimi	Statusi i kualifikimit jepet zyrtarisht për të gjithë konsumatorët, duke përfshirë edhe familjet, por në praktikë ndërrimi i një furnizuesi mbetet ende për tu realizuar duke qënë se ligji i ri për sektorin e energjisë elektrike nuk është zbatuar në praktikë për shkak të legjislacionit të munguar sekondar, i cili duhet të miratohet në një periudhë tranzitore 1 vjeçare.
Hapja e Tregut	Aktualisht vetëm një numër i vogël i konsumatorëve të mëdhenj marrin furnizimin e tyre me energji elektrike jashtë sistemit të rregulluar të furnizuesit publik OSHEE. Për pjesën tjetër të konsumatorëve, tregu është praktikisht i mbyllur gjatë periudhës së tranzicionit. Në praktikë, KESH dominon tregtimin me shumicë, ndërsa OSHEE kontrollon atë pakicë.
Ndarja e Operatorëve	OST (Operatori i Sistemit të Transmetimit) është ligjërish i ndarë, ndryshe nga rasti i Operatorit të Sistemit të Shpërndarjes OSHEE. OST do të jetë plotësisht i ndarë në pronësi, para përfundimit të vitit 2017, në shkelje të Direktivës duke qënë se ndarja është dashur të realizohet deri më 1 janar 2015.

BURIME: Raporti i Progresit mbi Zbatimin e Ligjit (Acquis) të Energjisë të Komunitetit Evropian të Energjisë, 2015

## GRAFIKU 1: Raportet Financiare (2014)

Raporti Borxh / Borxh Afatgjatë mbi 1 nënkupton mungesë stabilitetit financiar.  
Raporti për treguesit e likuiditetit nën 1 tregon aftësi të kufizuar për t'i shërbyer shpenzimeve operative të kompanisë.



BURIMI: Përlogaritjet e autorit bazuar në Raportet Financiare Vjetore të Ndërmarrjeve Shtetërore

## TABELA 2: Zbatimi i Ligjit (Acquis) për Energjinë

Legjislacioni Primar	Përbushur
Akte Ligjore Plotësuese	Në Progres
Organizimi Paraprak i Tregut	Në Progres
Balancimi i Tregut Kombëtar	Në Progres
Liberalizim i Çmimit	Në Progres
Ndarja e Operatorit të Sistemit të Shpërndarjes	Asnjë Progres
Ndarja e Operatorit të Sistemit të Transmetimit	Asnjë Progres
Pavarësia e ERE-s	Në Progres

BURIMI: Raporti i Progresit të Komunitetit Evropian të Energjisë, 2015

## REKOMANDIME POLITIKE:

- Të përforcohet shpejt Ligjin për Sektorin e Energjisë Elektrike me legjislacionin e duhur sekondar, trajnimin dhe rritjen e ndërgjegjësimit.
- Të përfundohet transpozimi i Ligjit të Energjisë të BE-së përpara fillimit të operimit të TAP.
- Të punohet në drejtim të diversifikimit të burimeve të energjisë.
- Të krijohet një mekanizëm që prodhon drejtues të pavarur dhe profesionistë, të cilët mund të menaxhojnë kompanitë publike në mënyrë të pavarur.
- Të riorganizohet procesi i prokurimit në fushën e energjisë, duke përfshirë disponueshmërinë e të dhënave të hapura në të gjitha fazat.

BURIMI: Raporti Rajonal i Vlerësimit të Qeverisjes në Energjetikë dhe Kapjes së Shtetit, SELDI, 2016.

## PROKURIMI PUBLIK:

Ndërkohë që ligjërisht ekzistojnë parakushte të mjaftueshme për transparencën e procesit të prokurimit publik, në praktikë ky nuk është rasti, veçanërisht për sektorin e energjisë në Shqipëri. Që prej vitit 2009, Shqipëria ka prezantuar një sistem të prokurimit elektronik, i cili duhet të sjellë ulje të konsiderueshme në rreziqet e korrupsionit të prokurimit publik, nëse lejohet zhvillimi i analizave dhe zbatimit të duhur të funksionimit të sistemit. Megjithatë deri më tani Agjencia e Prokurimit Publik (APP) nuk ka nxjerrë të dhëna për përdorim të gjerë publik, gjë e cila pengon përpjekjet për diagnostikimin e efikasitetit dhe propozimin e monitorimit efektiv të performancës. Pjesa më e madhe e informacionit në dispozicion të publikut është e formës ligjore, dhe jo e natyrës së bazuar në performancë ose qeverisje. Buletini i Prokurimit Publik është i publikuar në internet që nga viti 2008, por kjo nuk lejon një analizë të bazës së të dhënave, edhe pse ato kanë në përmbajtje një sërë të dhënash, të përgatitura çdo javë dhe të përditësuara në kohën e duhur. Raportet vjetore të APP-së sigurojnë çdo vit të dhëna për procedurat e përgjithshme të prokurimit të kryera nga agjencia. Në vitin 2009 u krijua një komision i Prokurimit Publik (PPC), i cili siguroi një ndarje të politikave dhe zbatimit nga funksionet e mjeteve juridike, si për kontratat publike ashtu edhe për koncesionet, duke e çuar sistemin më tej në përputhje me standardet e BE. Në tërësi, ndërkohë që sistemi institucional për qeverisje më të mirë të prokurimit publik në Shqipëri është në fuqi, ka nevojë për më tepër punë që ajo të japë rezultatet e nevojshme. Energjetika mbetet një shqetësim i veçantë duke qënë se shpesh përjashtohet nga rregullat e përgjithshme.

BURIMI: Raporti Rajonal i Vlerësimit të Qeverisjes në Energjetikë dhe Kapjes së Shtetit, SELDI, 2016.

